



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 2341 prot.
14

Tiranë, 11.7.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik Florian Ballhysa kundër vendimit nr.22, datë 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Edmond Islamaj.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 i Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 26.06.2018 është njoftuar vendimi nr.22 datë 07.06.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Edmond Islamaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C pika 2, Nenit F pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63 pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15 ditor nga dita e njoftimit.

Brenda afatit ligjor, unë Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr.22 datë 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

1. Subjekti i rivlerësimit z. Edmond Islamaj është magjistrat/gjyqtar prej vitit 1992 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 4 e ligjit nr.84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë.

2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Edmond Islamaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuar për këtë subjekt nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim i referuar si Inspektoriati), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33 pika 5 e ligjit nr.84/2016, me anë të "*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Edmond Islamaj¹*", ka referuar për subjektin, se:

- i.* Ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
- ii.* Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii.* Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv.* Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v.* Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39 pika 2 të ligjit nr.84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin², ka referuar "*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*".

2.3 Inspektoriati, bazuar në nenin 43 pika 2 e ligjit nr.84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit³ raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit, nga analiza e të cilit, sëbashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (6), Komisioni nuk ka gjetur elementë që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cënojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

¹ Protokolluar pranë Komisionit me nr.438 prot., datë 17.11.2017.

² Protokolluar pranë Komisionit me nr.64 prot., datë 15.11.2017.

³ Protokolluar pranë Komisionit me nr.2912/2 prot., datë 21.11.2017.



3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, Komisioni e ka fokusuar hetimin administrativ në verifikimin e vërtetësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve mbi gjendjen pasurore, burimin dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre, të ardhurave dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, duke kërkuar informacion nga subjekte të së drejtës publike dhe ato private⁴.

3.2 Nga kontrolli financiar-ligjor për 8 pasuritë e paluajtshme (2 në pronësi të subjektit, 3 në pronësi dhe 2 në përdorim të bashkëjetueses dhe 1 në pronësi të fëmijëve të tyre), llogaritë bankare, depozita dhe likuiditete (të subjektit dhe bashkëjetueses së tij) në shumën totale prej 41,857 Euro, 1,191,617 lekë dhe 12,101.4 USD, pronësinë dhe tjetërsimin e autoveturave të subjektit dhe bashkëjetueses së tij, Komisioni ka vlerësuar se nuk ka dyshime dhe në të gjitha rastet e hetuara, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga autoritetet shtetërore/private. Sipas Komisionit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të saj.

4. **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr.84/2016, Komisioni pas administrimit të raportit të përgatitur nga DSIK-ja, në përfundim ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionit, për kriterin e vlerësimit të figurës, subjekti është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

5. **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr.84/2016, Komisioni pasi ka administruar raportin e përgatitur nga Inspektoriat⁵, vlerësimit “i aftë” nga ana e relatorit të çështjes, hetimit dhe vlerësimit të 6 denoncimeve nga publiku, ka arritur në konkluzionin se nuk është gjetur asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që çënojnë figurën e mgagjistratit/gjyqtar. Sipas Komisionit, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti ka arritur një nivel të lartë të aftësive profesionale.

⁴ Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit, janë administruar prova/akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, DRPT, drejtoritë rajonale të tatimeve, QKB, ISSH, DPSHTR, OSHEE, etj.

⁵ Bazuar në formularin e vetëdeklarimit, 6 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së.

6. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter rivlerësimi, Komisioni bazuar në nenin 58, pika 1, germa "a" dhe nenit 59, pika 1 të ligjit nr.84/2016, ka vendosur, konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

II. Shkaqet e ankimit.

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioneri Publik është një nga tre institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit (vetting).
8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese (në vijim referuar si Kolegji).
9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga dispozitat e nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, neneve 48-52 të ligjit nr.84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa patur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.
10. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin në detyrë ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt.
11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik gjatë shqyrtimit të vendimit nr.22, datë 07.06.2018 të Komisionit, e ka kryer këtë kontroll, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore.
12. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tre kriteret e rivlerësimit të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, Komisioneri Publik konstaton se përsa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimi nr.22, datë 07.06.2018 i Komisionit, bazohet në provat dhe faktet që janë administruar gjatë hetimit administrativ.



13. Ndërkohë, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr.84/2016, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të këtij kriteri për subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare përfshirë interesat privatë të subjektit dhe personave të lidhur me të. Duhet nënvizuar, se në çdo rast, për arritjen e nivelit të besueshmërisë në vlerësimin e këtij kriteri, subjekti duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave.

14. Mbështetur në kërkesat kushtetuese e ligjore të sipërcituara dhe vlerësimin e provave dhe fakteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në rastin konkret ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr.22, datë 07.06.2018 të Komisionit ushtrohet vetëm për kriterin e kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit z. Edmond Islamaj.

15. Komisioneri Publik, çmon se procesi i hetimit i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk është i plotë, ka mangësi dhe për rrjedhojë në gjëndjen që janë aktet nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij, sipas nenit 59/1, gërma "a" të ligjit nr.84/2016.

16. Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se nëpërmjet këtij instrumenti procedural (ankim), do të bëjë të mundur që këto mangësi të vërejtura gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit, të mund të riparohen gjatë shqyrtimit të ankimit nga ana e Kolegjit.

17. Pika 3, e nenit F të Aneksit të Kushtetutës, parashikon shprehimisht se: *"3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj."*

18. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, Neni F, pika 3 dhe 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr.84/2016, në vijim paraqesin vlerësimin dhe shkaqet e ankimit për secilin aset pasuror, të paluajtshëm e të luajtshëm, në pronësi apo përdorim të subjektit dhe personave të lidhur me të, likuiditetet, vlerësimin mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe nevojën për hetimin e tyre nga ana e Kolegjit.

II.A Vlerësimi mbi pasuritë e paluajtshme

(në pronësi/përdorim të subjektit të rivlerësimit z Edmond Islamaj, bashkëjetueses znj S. T dhe fëmijëve të mitur)

19. Subjekti i rivlerësimit z Edmond Islamaj, ka deklaruar në pronësi **një apartament me sip. m², nr.pasurie** , ZK nr. , ndodhur në Rr.

Fillimisht kjo pasuri është deklaruar në bashkëpronësi me prindërit, me pjesë takuese 1/3, fituar me anë të kontratës së privatizimit të banesave shtetërore për vlerën 22,509 lekë.

19.1 Origjina e kësaj prone ka për bazë legjislacionin e vitit 1992 për privatizimin e banesave shtetërore materializuar në kontratën e privatizimit të banesave datë 20.08.1993, lidhur ndërmjet NK Banesave dhe të atit të subjektit të rivlerësimit z. B. I Kontrata e privatizimit është pasuar me kontratën e shit-blerjes të datës 05.10.1993, lidhur midis palës shitëse NKB dhe palës blerëse, prindërit e subjektit z. B. I dhe znj. H. I subjekti i rivlerësimit z. E. Islamaj dhe vëllai i tij z. E. I

19.2 Fillimisht kjo pasuri ka qenë në bashkëpronësi në raportin e 1/3 pjesë takuese për subjektin e rivlerësimit dhe 2/3 prindërve të tij, pasi vëllait të subjektit z. E. I duke qenë i mitur, nuk i njihet e drejta për të qenë bashkëpronar në këtë pasuri të provatizuar.

19.3 Raporti ligjor për të drejtat e pronësisë mbi këtë pasuri për subjektin e rivlerësimit ka ndryshuar, krahasuar me deklaratën "Vetting", dorëzuar më datë 31.01.2017. Më datë 17.04.2017 me anë të kontratës së dhurimit me nr. rep dhe nr. kol., lidhur para një noteri publik të Dhomës së Noterisë Durrës, prindërit e subjektit i kanë dhuruar atij pjesën e tyre takuese prej 2/3, duke u bërë subjekti pronar i vetëm i kësaj pasurie.

19.4 Në mbështetje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30⁶ të ligjit nr.84/2016, hetimi i Komisionit për këtë pasuri është i plotë dhe vlerësimi përfundimtar është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktësisht dhe me vërtetësi.

20. Subjekti i rivlerësimit z Edmond Islamaj, ka deklaruar në pronësi **një pasuri "kullotë" me sip. m², nr. pasurie** , ZK nr. , e ndodhur në

20.1 Origjina e kësaj prone ka për bazë kontratën e shit-blerjes me nr. rep., dhe nr. kol., e datës 26.03.2015, e lidhur para një noteri publik i Dhomës së Noterisë Tiranë. Në këtë kontratë, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e blerësit, ndërsa në cilësinë e shitësit është shtetasi shqiptar, z.A.H dhe bashkëshortja e tij, shtetase e Republikës së Afrikës së Jugut, znj.C.L.W.

⁶ Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

20.2 Çmimi i blerjes së kësaj pasurie, bazuar në përmbajtjen e kontratës është 137.000 lekë.

20.3 Për burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën "Vetting" subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga në vite, burim ky, i cili po t'i referohemi çmimit të deklaruar në kontratën e shitjes, justifikohet nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve.

20.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në disa elementë.

20.4.1 Çmimi i shitjes në favor të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 137 Lekë për m², është edhe më i ulët se çmimet e referencës, përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të RSH", i ndryshuar⁷, e për më shumë në një zonë me përparësi të madhe turistike.

20.4.2 Shitësi, z.A.H përpara tjetërsimit të pronësisë tek subjekti, nga shënimet e dokumentave hipotekorë, rezulton se e regjistron për herë të parë këtë pronë në emër të tij në datë 04.02.2015 dhe në datë 26.03.2015 ia shet subjektit të rivlerësimit.

20.4.3 Të dyja këto fakte, duhej ta kishin detyruar Komisionin, që në referencë dhe të standartit tashmë të vendosur prej tij në raste të ngjashme, kujtojmë këtu hetimin administrativ të Komisionit që konkludoi me marrjen e vendimin nr.13, datë 05.04.2018, të kryente një hetim të plotë dhe bazuar në nenin 50 të ligji nr.84/2016 të kërkonte informacion nga ZVRPP në lidhje me çmimin e transaksioneve të shit-blerjeve të pronave të tjera kufitare, me atë të blerë nga subjekti dhe origjinën e pronësisë së shitësit mbi këtë sipërfaqje toke.

21. Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, znj. S.T rezulton se ka në pronësi 3 pasuri të paluajtshme.

22. Megjithëse në cilësinë e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. S.T prej vitesh (v.2005 deklarimi i parë) mbart detyrimin e deklarimit të interesave privatë, pronësia e saj mbi këto pasuri të paluajtshme, që referohet se është fituar që në vitin 2001 nuk është deklaruar asnjëherë dhe deklarohet për herë të parë vetëm në deklaratën "Vetting" në vitin 2017.

22.1 Konkretisht, znj. S.T deklaron se në një pallat në Rr. " " - Blvd. , ka në pronësi si pronare e vetme, pasuritë:

22.1.1 "Apartment" me sipërfaqje 141.13 m², nr. pasurie , ZK nr. ;

⁷ Çmimi i referencës është 151 lekë/m².



22.1.2 "Njësi"/ambient tregtar me sip.55 m², nr. pasurie [redacted], ZK nr [redacted]

22.1.3 "Garazh" me sip.16 m², nr. pasurie [redacted], ZK nr. [redacted]

22.2 Titulli i pronësisë i znj S.T mbi këto tre pasuri të paluajtshme është deklaruar se është fituar nga kontrata e shit-blerjes nr. [redacted] rep., dhe nr. [redacted] kol., datë 10.11.2001, lidhur para një noteri publik të Dhomës së Noterisë Durrës, ndërmjet znj. S.T. në cilësinë e blerëses dhe të atit të saj, z.A.T. ⁸ në cilësinë e shitësit, për çmimin total 1.000.000 lekë. Kjo pronësi pretendohet të jetë regjistruar në emër të znj. S.T me nr. [redacted] hipotekor, datë 19.01.2002 në regjistrat hipotekor të ZVRPP Durrës.

22.3 Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, babai i bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, z. A.T i ka fituar këto pasuri të paluajtshme nga kontrata noteriale e sipërmarrjes nr. [redacted] rep., nr. [redacted] kol., datë 17.09.1998 dhe akt marrëveshja noteriale nr. [redacted] rep., nr. [redacted] kol., datë 28.12.2000 me shoqërinë e ndërtimit [redacted] shpk. Me anë të këtyre veprimeve juridike, z. A.T ka vënë në dispozicion të shoqërisë së ndërtim një sipërfaqje trualli të përfituar nga zbatimi i legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave, duke marrë në shkëmbim apartamente, njësi tregtare dhe garazhe në objektin e ndërtuar mbi këtë sipërfaqje trualli. Kjo pronësi në emër të z.A.T pretendohet të jetë regjistruar me nr. [redacted] hipotekor, datë 08.02.2001 në regjistrat hipotekor të ZVRPP Durrës.

22.4 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar nga ZVRPP Durrës përcjelljen e dokumentacionit në lidhje me pasuritë në emër të subjektit të rivlerësimit, të bashkëjetueses, fëmijëve të mitur dhe prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses.

22.5 Nga aktet e përcjella prej ZVRPP Durrës, me shkresën nr. [redacted] prot., datë 15.01.2018 rezulton se regjistrimi nr. [redacted] hipotekor, datë 19.01.2002 për regjistrimin e pasurive në emër të znj. S.T mungon. Po ashtu, mungon regjistrimi nr. [redacted] hipotekor, datë 08.02.2001 për regjistrimin e pasurive në emër të z. A.T.

22.6 Nga aktet e përcjella prej ZVRPP Durrës, me shkresën nr. [redacted] prot., datë 15.01.2018 rezulton se kalimi i pronësisë për pasuritë e paluajtshme të lartpërmendura nga shoqëria e ndërtimit "[redacted]" shpk tek z.A.T është regjistruar në datë 04.05.2012.

⁸ Origjina e këtyre pasurive për z. A.T vjen nga kontrata e sipërmarrjes me nr. [redacted] rep dhe nr. [redacted] kol e datës 17.09.1998, pasuar me akt-marrëveshjen për përcaktimin e pjesëve takuese dhe regjistrimin e pasurive, me nr. [redacted] rep, nr. [redacted] kol e datës 28.12.2000, lidhur me shoqërinë "E [redacted]" sh.p.k. Nga përmbajtja e akt-marrëveshjes, rezulton se i ati i bashkëjetueses së subjektit duke qenë pronar i një trualli me sip. [redacted] m², ndodhur në Rr. "[redacted]" ka vënë në dispozicion të shoqërisë ndërtuese "[redacted]", në cilësinë e sipërmarrësit, për ndërtimin e një pallati katësh. Pas përfundimit të ndërtimit, regjistrimit të tij dhe truallit në favor të shoqërisë, kjo e fundit i ka kaluar pronësinë z.A.T [redacted], të dy garazhave me sip. [redacted] dhe [redacted] m², një lokali me sip. [redacted] m² dhe dy apartamente me sip. [redacted] m² secili.

22.7 Nga aktet e përcjella prej ZVRPP Durrës, me shkresën nr. _____ prot., datë 15.01.2018 rezulton se kalimi i pronësisë për pasuritë e paluajtshme të lartpërmendura nga z. A.T tek znj S.T është regjistruar në datë 14.05.2012, me numër reference hipotekore _____ .

22.8 Nga aktet e përcjella prej ZVRPP Durrës, me shkresën nr. _____ prot., datë 15.01.2018, rezulton se me urdhër nr.regj. _____ , datë 15.05.2012 është bërë rivlerësimi i të tre pasurive të paluajtshme duke rezultuar me këto vlera:

22.8.1 **Apartament** - 10.519.930 lekë,

22.8.2 **Njësi/ambient tregtar** - 6.149.550 lekë,

22.8.3 **Garazh** - 834.848 lekë.

22.9 Duke krahasuar kartelat e pasurisë së dorëzuara bashkëlidhur deklaratës “Vetting” nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe kartelave të pasurisë të përcjella nga ana e ZVRPP Durrës me shkresën nr. _____ prot., datë 15.01.2018 ka mospërputhje të datës dhe numrave hipotekorë të regjistrimit të veprimeve juridike, që kanë kaluar të drejtën e pronësisë në emër të znj. S. T.

23. Pavarësisht, detyrimit të parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, rezulton se znj. S.T në cilësinë e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e këtyre tre pasurive të paluajtshme në shumën 1.000.000 lekë.

23.1 Duke iu referuar datës së lidhjes së kontratës së shitjes për këto tre pasuri të paluajtshme 10.11.2001, rezulton se znj. S. T, e vitlindjes 1977, për atë periudhë ka deklaruar të ardhura vetëm nga një marrëdhënie punësimi me një person juridik në formën e organizatës jofitimprurëse.

23.2 Qendra _____ , në datë 30.01.2017, ka lëshuar një vërtetim në bazë të së cilit, administratorja znj. H.Z, rezulton të ketë deklaruar se znj. S.T ka qnë kontraktuar si përkthyes pranë kësaj qendre në periudhën tetor 1999 – korrik 2000 duke përfituar një pagesë prej 500 USD në muaj.

23.3 Për të tre këto pasuri të paluajtshme në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka qenë i saktë dhe i vërtetë në deklaram dhe të ardhurat justifikojnë blerjen e pasurive.

24. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndron në disa elementë.



24.1 Nëse të ardhurat e bashkëjetueses sipas vërtetimit të dorëzuar nga subjekti i datës 30.01.2017, lëshuar nga Qendra do të konsiderohen të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr.84/2016, Komisioni nuk ka hetuar, nuk ka pyetur subjektin e rivlerësimit, bashkëjetuesen e tij dhe vlerësuar nëse për shumën 730.386,84⁹ lekë, që janë të ardhurat e vetme të bashkëjetueses për periudhën 1999-2001, janë paguar ose jo detyrimet tatimore.

24.2 Komisioni, në referencë dhe të standartit tashmë të vendosur prej tij në raste të ngjashme, kujtojmë hetimin administrativ të Komisionit që konkludoi me marrjen e vendimit nr.12, datë 23.03.2018, ka patur korrespondencë dhe ka administruar në cilësinë e provës të dhëna nga organet tatimore përkatëse për vërtetimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara apo pretenduara si burim krijimi pasurie nga subjektet e rivlerësimit.

24.3 Megjithëse Komisioni, shumën e të ardhurave prej 730.386,84 lekë, si e ardhur nga paga pranë qendrës e ka konsideruar të ligjshme dhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë për bashkëjetuesen e subjektit i llogarit në vlerën 0 lekë, nga analiza financiare për të ardhurat dhe shpenzimet (shih tab.nr.1) rezulton se ato sërisht nuk mbulojnë vlerën totale për blerjen e pasurive¹⁰, me një diferencë prej **269,613.16 lekë**.

Tabela nr. 1

Raporti i të ardhurave/shpenzime për S.T	periudha 1999-2001	Vlera në lekë
Të ardhurat nga paga në qendrën	1-viti 1999	730.386,84 ¹¹
Shpenzimit për blerjen e pasurive sipas kontratës të datës 10.11.2001-viti 2001		1,000,000.00
Diferencë e pambuluar		(269,613.16)

24.4 Kjo diferencë në të ardhurat dhe shpenzimet e znj S. T për blerjen e këtyre tre pasurive do të duhej ta kishte shtyrë Komisionin për të kryer një hetim më të thelluar nisur edhe nga një provë tjetër që e ka administruar në fashikull. Me shkresën nr. 1000/2018 prot., datë 01.02.2018¹² OSHEE ka informuar Komisionin në lidhje me kontratat aktive për furnizimin me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëjetueses së tij dhe prindërve përkatës.

24.4.1 Rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit z Edmond Islamaj, në datë 05.05.2001, është lidhur një kontratë furnizimi me energji elektrike për abonent të kategorisë “familjarë”

⁹ Kundërvlera e 5.000 euro, konvertuar me kurs mesatar për vitin 2000, referuar arkives së këmbimit valutor të BSH, 1 USD = 146.077 lekë.

¹⁰ Sipas pikës 3 të kontratës së shitblerjes së datës 10.11.2001, blerësja znj.S.T ka likuiduar çmimin total 1.000.000 lekë jashtë zyrës noteriale.

¹¹ Kundërvlera e 5.000 USD me kursin zyrtar të BSH.

¹² Shkresa e OSHEE nr. 1000/2018 prot.datë 01.02.2018 konfirmon se Edmond Islamaj, është abonent familjar i kontratës nr. 1000/2018, lidhur më datë 05.05.2001, me adresë J.P. lagja n. , shk. , ap. Durrës, që përputhet me adresën e apartamentit të deklaruar në pronësi nga bashkëjetuesja.



me nr.kontrate _____ në adresën rr. _____, Sh. _____, Ap. _____, që rezulton të jetë adresa e apartamentit të lartpërmendur në pronësi të bashkëjetueses znj. S.T.

24.4.2 Konstatohet se kontrata e furnizimit me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit z Edmond Islamaj, daton përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes mes znj. S. T dhe babait të saj z. A.T.

24.4.3 Nisur nga rrethana ligjore kur edhe në momentin e plotësimit të deklaratës "Vetting" subjekti i rivlerësimit bashkëjeton dhe nuk është i lidhur në martesë me znj. S. T dhe se bashkëjetesa në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjës është një marrëdhënie fakti, Komisioni në zbatim të neneve 48-52 të ligjit nr.84/2016 do të duhej të kishte shtrirë hetimin e tij në lidhje me verifikimin e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, në kushtet kur provohet se që prej vitit 2001, subjekti i rivlerësimit ushtron të drejta reale mbi këto pasuri.

24.5 Nisur nga kundërshtitë e konstatuara në përmbajtjen e dokumentacionit hipotekor të përcjellë nga ZVRPP Durrës dhe akteve noteriale në lidhje me momentin e pretenduar për fitimin e pronësisë nga ana e znj. S. T (viti 2001) për këto tre pasuri dhe datën e regjistrimit hipotekor të tyre në regjistrat përkatës (viti 2012), Komisioni në kuptim të nenit 50 të ligjit nr.84/2016 do të duhej t' i kishte kërkuar ZVRPP Durrës informacion në lidhje me procedurën e ndjekur për regjistrimin e këtyre pasurive bazuar në kërkesat e legjislacionit përkatës për regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

24.6 Vlen për t' u nënvizuar fakti që në rast se titulli i pronësisë mbi këto tre pasuri të paluajtshme i vitit 2001 në emër të znj. S. T është regjistruar në regjistrat hipotekor në vitin 2012, sikundër rezulton nga shënimet e kartelave të pasurisë, do të duhej hetuar vlera e penaliteteve të paguara nga subjekti pronar i pasurive, për regjistrimin me vonesë të titujve të pronësisë, ashtu sikurse parashikon legjislacioni në fuqi. Duke qenë se vlera financiare e penalitetit, mund të jetë eventualisht e lartë, mund të përbënte interes për vlerësimin e saj në raport me të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara nga subjekti i lidhur.

25. Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, znj. S.T rezulton se ka në përdorim (pa titull), dy garsionere me sip. _____ m² secila, ndodhur te _____

25.1 Referuar deklarimeve, bashkëjetuesja e subjektit nuk disponon dokumentacion lidhur me pronësinë/përdorimin e këtyre pronave, pasi babait të saj, z. A.T, i cili ia ka lënë në përdorim, nuk i kanë kaluar ende të drejtat e pronësisë.

25.2 Marrëdhënia juridike e z.A.T dhe vajzës së tij me këto dy pasuri të paluajtshme, rrjedh nga vendimi nr. _____, datë _____ i KKKP Durrës. Ky vendim i ka njohur dhe kthyer fizikisht tokë me sip. _____ m² në parcelën nr. _____ sipas kufizimeve përkatëse, trashëgimtarëve të H.T



(gjyshi i bashkëjetueses¹³). E drejta e pronësisë mbi truallin sipas vendimit të sipërcituar, regjistrohet në regjistrin hipotekor me nr. _____ datë _____. Sipas kartelës së pasurisë (pa datë), trualli _____ m² në ZK _____ me nr.pasurie _____ rezulton në bashkëpronësi të z.A.T _____ dhe dy motrave të tij.

25.3 Me kontratën e sipërmarrjes nr. _____ rep dhe _____ kol, e datës _____ shoqëria _____ sh.p.k dhe z.A.T, përfaqësues me prokurë edhe i të motrave të tij (megjithëse ato rezultojnë se kanë nënshkruar), kanë rënë dakord që këta të fundit të venë në dispozicion për ndërtimin e një pallati, truallin në pronësi të tyre dhe raporti i bashkëpronësisë me shoqërinë private pas përfundimit të ndërtimit, të jetë 77% për shoqërinë dhe 23% për pronarët e truallit. Referuar nenit 6 të kësaj kontrate, palët kanë rënë dakord gjithashtu se për realizimin e ndërtimit dhe garantimin e marrëveshjes, prona të vihet në hipotekë në favor të shoqërisë _____ sh.p.k dhe të hiqet pas përfundimit të punimeve duke bërë kështu edhe kalimin, regjistrimin e pjesëve takuese të bashkëpronësisë, sipas raporteve të rëna dakord.

25.4 Nga dokumentet e administruara, pohimet e subjektit të rivlerësimit dhe pohimet e z.A.T, i thirrur si person i lidhur e që ka dijeni, rezulton se për arsye të ndryshme që pretendohen se lidhen me mospërfundimin e plotë të ndërtimit nga shoqëria e ndërtimit, kontrata e sipërmarrjes nuk i ka ezauruar efektet e plota juridike, me qëllim regjistrimin e ndërtimit në hipotekë dhe ndarjen e pjesëve takuese midis bashkëpronarëve, përfshirë këtu edhe dy garsioneret. Aktualisht situata juridike paraqitet e tillë që pronarët e truallit kanë marrë në përdorim/posedim dhe jo në pronësi disa apartamente/garsionere, dy prej të cilave bashkëjetuesja e subjektit i ka deklaruar në përdorim në deklaratën "vetting".

25.5 Në lidhje me detyrimin ligjor për deklarimin e të drejtave reale, përdorimit/posedimit mbi këto pasuri të paluajtshme, konstatojmë se ato nuk janë deklaruar prej vitit 2010-2011 e në vijim, moment në të cilin subjekti i rivlerësimit fillimisht pohon se i ka pasur në huapërdorje, e më pas kundërsqaron se "*nga pikëpamja faktike, garsioneret nuk janë përdorur nga ana e bashkëshortes time, për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe kushteve jo të përshtatshme*"¹⁴..

26. Fëmijët e mitur të subjektit të rivlerësimit, L.I dhe M.I rezulton se kanë në pronësi një pasuri të paluajtshme ndërtesë + truall, të dyja me të njëjtën sipërfaqje prej _____ m². Në regjistrat hipotekorë të ZVRPP Durrës, pasuria është e regjistruar me nr. _____, ZK nr. _____, e ndodhur në Blvd. Kryesor, Durrës.

¹³ Referuar dëshmisë së trashëgimisë me nr. _____, datë 26.02.1993, trashëgimtarët e vijës së parë për _____, janë dy vajzat dhe djali i tij, L. H _____, S. Q _____ dhe A. _____

¹⁴ Referuar përgjigjeve të subjektit për KPK, të datës 15.02.2018.



27. Nga aktet e përcjella prej ZVRPP Durrës, me shkresën nr. _____ prot., datë 15.01.2018, rezulton se ne datë 22.05.2017 në regjistrat hipotekorë është regjistruar pronësia e fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit mbi pasurinë e mësipërme.

28. Rezulton se pronësia e dy fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri e ka origjinën nga kontrata e dhurimit, nr. _____ rep. _____ kol, e datës _____ e lidhur para noterit publik, të Dhomës së Noterisë Durrës, nëpërmjet të cilës prindërit e subjektit të rivlerësimit z. B.I dhe znj. H.I ua dhurojnë këtë pasuri nipërve të tyre. Në cilësinë e pranuesve të dhurimit janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja znj. S.T, si prindër të fëmijëve të mitur.

28.1 Rezulton po ashtu, se origjina e pronësisë për babain e ndjerë të subjektit të rivlerësimit z. B.I, rrjedh nga kontrata e shit-blerjes (truall+ndërtesë) me nr. _____ rep., nr. _____ kol., e datës _____, e lidhur para noterit publik të Dhomës së Noterisë Durrës, ndërmjet B.I (babai i subjektit) në cilësinë e blerësit, dhe palës shitëse, z. A.T (babai i bashkëjetueses së subjektit) dhe shtetasve S.Q, B.H & S.H (motra dhe trashëgimtarët e motrës të tij). Nga përmbajtja e kontratës (fq.2 paragf. i fundit), pagesa e çmimit total të pasurisë në vlerën 3.000.000 lekë është kryer me anë të pagesës në _____ dhe urdhër transferi duhet t'i bashkëngjitet kontratës si pjesë integrale e saj, provë e cila mungon dhe nuk është pjesë e kontratës.

28.2 Nga aktet e përcjella prej ZVRPP Durrës, me shkresën nr. _____ prot., datë 15.01.2018, rezulton se rivlerësimi i pronës¹⁵ është bërë (dy herë) në datë _____ në vlerë 11.154.418 lekë dhe datë _____, me vlerë 9.111.967 lekë, ndërsa çmimi i shitjes në kontratë është dakortësuar mes palëve në një vlerë 3 herë më të vogël.¹⁶

29. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit ka rezultuar se në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie të paluajtshme, z. B.I dhe z. A.T kanë kryer disa transaksione bankare pranë _____.

30. Kështu, në përgjigjen që i drejtohet Komisionit, për të vënë në dispozicion të dhëna për transaksionet bankare të z. B.I dhe z. A.T për këtë kontratë shitblerje, _____, me shkresën nr. _____, datë 08.05.2018 ka përcjellë të gjithë praktikën dokumentare të transaksioneve të kryera nga dy personat e lartpërmendur.

30.1 Nga përmbajtja e dokumentacionit bankar, përshkrimet e mandat pagesave, rezulton se z.A.T (babai i bashkëjetueses së subjektit) dhe z.B.I (babai i subjektit të rivlerësimit) rezulton se kanë hyrë në marrëdhënie huamarrje mes tyre, ku ky i fundit i ka marrë hua shumën 3.000.000 lekë z.A.T, për blerjen e pasurisë, e cila më pas iu dhurua fëmijëve të mitur të

¹⁵ Sipas kartelave respektive të pasurisë bashkëlidhur shkresës ZVRPP Durrës nr. _____ datë _____, protokolluar në KPK nr 1177/2 datë 17.1.2018.

¹⁶ Shih vendimin e Komisionit (fq 19) cit : "ndërrimi i pronësisë nuk është shoqëruar me tatimin përkatës".



subjektit të rivlerësimit. Dokumentacioni bankar i përcjellë me shkresën nr. _____ prot, datë 08.05.2018 të _____ tregon qartë mënyrën dhe kohën e pagesës pranë kësaj banke (PCB), sipas lëvizjeve të llogarive bankare të palëve kontraktuese.

30.2 Rezulton se në datë 24.10.2014, në orën 10:00:12, në sportelin nr. _____ të _____ dega Durrës, z.A.T (shitësi) tërheq 600 copë kartmonedha me prerje 5.000 lekëshe, total 3.000.000 lekë, referuar transaksionit nr. _____.

30.3 Po në të njëjtën datë, në orën 10:05:50, në po të njëtin sportel, B.I (blerësi) derdh në llogarinë e tij 3.000.000 lekë (llogari e hapur atë ditë, në të njëjtën datë me transaksionin), 600 copë kartmonedha me prerje 5.000 lekëshe, referuar transaksionit nr. _____ me përshkrimin: "*Tërheqje nga llogaria A.T _____ marrë hua, depoziton B.I _____*".

30.4 Më pas, babai i subjektit të rivlerësimit, z.B.I, referuar urdhër transfertës së datës 24.10.2014, ora 10:17:14, nga sporteli _____ i _____, dega Durrës, ka kaluar në llogarinë e noterit z.Sh.C, shumën 3.000.000 lekë me përshkrimin: "*Transferim për blerje shtëpi private lagjja nr. _____ rruga _____*".

31. Në lidhje me këto paqartësi të transaksionit dhe marrëdhënien e huasë, Komisioni, ka pyetur z.A.T¹⁷, si person i lidhur që ka dijeni. Nga procesverbali i datës 20.4.2018, z.A.T mohon t'i ketë dhënë borxh shumën 3.000.000 lekë z.B.I, duke pretenduar se është banka që ka gabuar, duke pohuar ... "*ne s'kemi patur fare lekë*". Ndërkohë z.A.T pranon se ka marrë vlerën e plotë të shitjes së pasurisë, ndarë me tre shitësit e tjerë, pohim ky që jo vetëm nuk përputhet, por është në kundërshtim me çfarë rezulton nga dokumentacioni bankar. Në dëshminë e tij, pasi ka pohuar "*nuk di çfarë më ka kaluar noteri*", edhe pse ka deklaruar që do të sillte dokumentacionin provues "*pasi të konsultohej me bankën dhe noterin*", asnjë dokument nuk rezulton të jetë paraqitur në vijim prej tij dhe as nuk është kërkuar nga Komisioni.

32. Gjithashtu Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë me dokumentacion ligjor¹⁸, situatën e huamarrjes mes të atit të tij dhe babait të bashkëjetueses (për vlerën 3.000.000 lekë) me të cilën është financuar blerja e apartamentit. Subjekti, ashtu si edhe z.A.T mohon këtë huamarrje (nga babai i tij) duke sqaruar se përshkrimi i veprimit në bankë në llogarinë e A.T nuk është i saktë, por nuk ka sjellë asnjë dokumentacion provues për këtë pretendim të tij.

33. Situata e kësaj marrëdhënie huaje mes gjyshërve që prodhoi një dhurim në favor të nipërve/fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit, është kontradiktore dhe paraqitet e paqartë

¹⁷ Referuar nenit 24 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*".

¹⁸ Referuar pyetësorit nr.4 në dosje.

edhe në shpjegimet përfundimtare të subjektit¹⁹ para Komisionit, ku pohon: "...që nuk jam në dijeni që mes tyre të ketë pasur një marrëdhënie huaje, por nuk përjashtoj mundësinë e një marrëdhënie të tillë...." (fq. 4 e parashtrimeve).

34. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në disa elementë.

34.1 Edhe pse deklarimet e datës 20.04.2018, të dhëna nga z. A.T para Komisionit janë mbyllur me angazhimin e tij për të diskutuar me noterin që ka kryer transaksionin e shitjes dhe për të vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin ku mbështeteshin pretendimet e tij, ky dokumentacion nuk rezulton të jetë paraqitur nga z. A.T dhe nga ana e Komisionit nuk është kërkuar më asnjë shpjegim. Për më tepër, që disa ditë pas marrjes së deklarimit të z. A.T, Komisioni ka administruar shkresën nr. _____ datë 08.05.2018 të _____ me anë të së cilës është përcjellë e gjithë praktika bankare shkresore e plotë, që kundërshton deklarimet e marra nga z. A.T.

34.2 Është e vertëtë se vetë subjekti i deklarimit pretendon në shpjegimet e tij për një interesim të tij pranë bankës në fjalë dhe shpjegimet se dokumentacioni bankar mund të ketë pasaktasi në pjesën shpjeguese të veprimeve bankare, por në cilësinë e provës shkresore, mandatet e rregullta të arkëtimit nuk rezulton të jenë kontestuar.

34.3 Nisur nga të dhënat e përfituara nga dokumentacioni shkresor bankar, derdhjen e shumës prej 3.000.000 nga z. B.I në llogari të noterit z. Sh.C për llogari të transaksionit financiar të shitjes së pasurisë së paluajtshme konform parashikimit kontraktor, hetimi dhe marrja e informacioneve nga ana e noterit z. Sh.C në lidhje me këto veprime bankare do të ishte e nevojshme për Komisionin në kuptim të nenit 51 të ligjit nr.84/2016.

34.4 Në vështrim të nenin 32/4 dhe 52 të ligjit nr.84/2016, Komisioni do të duhej të kishte thelluar hetimin për burimin e pasurisë së dhuruar dy fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit, nisur edhe nga fakti që dy prindërit e subjektit, në momentin e blerjes së pronës, rezultojnë të dy të jenë me statusin e pensionistëve dhe pa të ardhura të tjera përveç përfitimeve nga skema e sigurimeve shoqërore. Megjithëse z. B.I, babai i ndjerë i subjektit të rivlerësimit, në momentin e kryerjes së këtij procesi rivlerësimi ka ndërruar jetë, palë e kontratës së dhurimit për dy fëmijët e mitur është nëna e subjektit të rivlerësimit, e cila në kuptim të dispozitave të Kodit të Familjes dhe Kodit Civil gëzonte të drejtën e bashkëpronësisë mbi sendin. Nisur dhe nga fakti se në emër të

¹⁹Neni C pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon që subjekti ka barrën e provës për këtë proces.



prindërve të subjektit të rivlerësimit rezultojnë depozita bankare në shuma të konsiderueshme, me qëllim hetimin e burimit të ligjshëm edhe për fitimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme në fjalë, Komisioni duhet të kishte marrë deklaratimet e saj.

II.B Vlerësimi mbi pasuritë e luajtshme (automjete) në pronësi dhe përdorim të subjektit dhe bashkëjetueses së tij.

Automjeti “Land Rover” Discovery, vit prodhimi 2005.

35.Subjekti i rivlerësimit dhe i ati i tij në vitin 2010 kanë blerë (pa kontratë) për çmimin 2.861.670 lekë (21,000 Euro) autoveturën “Land Rover” Discovery, vit prodhimi 2005, referuar faturës tatimore nr. datë 10.05.2010, lëshuar nga shoqëria sh.p.k²⁰.

36.Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, deklarohet blerja e këtij automjeti nga ana e subjektit dhe pronësia në masën 40%. Për 60% të vlerës, subjekti pretendon se është paguar nga i ati i tij i ndjerë z. B.I, në cilësinë e bashkëpronarit. Ky automjet regjistrohet në bashkëpronësi të subjektit dhe të atit të tij, referuar certifikatës së pronësisë datë 24.06.2010 dhe asaj të datës 05.07.2012, pasi ndryshohet targa (në AA950DX).

37.Hetimi dhe konkluzionet e Komisionit mbi veprimet e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e pagesës së çmimit të këtij automjeti janë të paqarta dhe nuk i përgjigjen gjendjes së faktit. Komisioni në vendim shprehet se: “... subjekti vërtetoi me dokumentacion bankar pagesën për blerjen e këtij mjetei, ndërsa të ardhurat nga shitja i deklaroi të marra cash, për shkak të marrëdhënieve shoqërore me blerësin²¹”.

38.Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në lidhje me këtë fakt, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit 3 akte shkresore në formën e fotokopjes së thjeshtë.

38.1Nga këto akte të fotokopjuara, 1 prej tyre, mandat pagesa e e datës 08.09.2010²² në vlerë 6.000 Euro, rezulton të jetë një transfertë e kryer nga ati i subjektit të rivlerësimit z. B.I, në favor të shoqërisë shpk.

38.2Ndërkohë për pagesën e pjesës tjetër të çmimit në vlerë 15.000 Euro, subjekti ka paraqitur dy dokumenta, shkresa të thjeshta, që datojnë 15.06.2010 dhe 07.07.2010, dhe që nuk

²⁰ Sipas dokumentit doganor i datës 21.04.2010 (gjendur në dosjen e dërguar Komisionit nga DPSHTRR, me anë të shkresës nr.23800/6 prot., datë 12.01.2018), shpk si shoqëri tregtare me qëllim fitimi, e kishte blerë automjetin në Itali në të njëjtën vlerë që ia shet subjektit të rivlerësimit + plus detyrime tatimore (16.500 euro+20% TVSH).

²¹ Referuar fq. 20 të vendimit të Komisionit.

²² Me përshkrimin “derdh... , likuid.. blerje automjeti në favor të shpk.

përmbajnë as vulë, as nënshkrime dhe as ekstremitet formale për të identifikuar kryerësit e veprimit financiar. Nëpërmjet këtyre dy akteve shkresore, subjekti i rivlerësimit z Edmond Islamaj pretendon se ka paguar ai vetë, në favor të shoqërisë " " përkëtsisht shumat prej 10,000 Euro dhe 5,000 Euro.

39. Në vitin 2014, katër vite pas blerjes, subjekti i rivlerësimit, duke nënshkruar dhe në emër të atit të tij z. B.I, me anë të kontratës noteriale së shit-blerjes me nr. rep., dhe nr. kol., datë 12.07.2014, lidhur pranë noterit publik Shijak, i shet automjetin "Land Rover" Discovery shtetasit L.Sh, për një vlerë prej 20.000 Euro. Blerësi L.Sh, rezulton vëllai i pronarit të shoqërisë shpk. Nga përmbajtja e kontratës, konstatojmë se i ati i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë prezent para noterit. Bazuar në përmbajtjen e kontratës, noteri e ka konsideruar të atin e subjektit të rivlerësimit, si të përfaqësuar nga ky i fundit, por nga aktet e administruara nuk rezulton asnjë prokurë që të legjitimojë këtë përfaqësim.

40. Referuar përmbajtjes së kontratës së datës 12.07.2014 mes subjektit të rivlerësimit dhe z. L. Sh, palët në kontratën noteriale kanë deklaruar se pagesa e çmimit do të bëhet nëpërmjet sistemit bankar, por nga analizimi i lëvizjeve bankare të subjektit dhe të atit të tij, nuk rezulton që kjo shumë të jetë depozituar në llogaritë e tyre.

40.1 Në shpjegimet përfundimtare, subjekti deklaroi se i ka marrë *Cash* me këste, për shkak të marrëdhënies shoqërore që ka pasur me blerësin, fakt i pranuar nga Komisioni, duke arsyetuar dhe mbi ligjshmerinë e transaksioneve CASH mes individëve.

41. Ndërkohë ka rezultuar se shtetasi që bleu automjetin nga subjekti i rivlerësimit për vlerën 20.000 Euro, dy ditë më pas, me kontratën nr. 1702 rep., dhe nr. 1647 kol., datë 14.07.2014, ia shet të njëjtin automjet "Land Rover" Discovery, shoqërisë sha, për vlerën 15.000 Euro.

42. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në disa elementë.

42.1 Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar pagesën e çmimit të blerjes së automjeti, Komisioni nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë e tyre ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i ka marrë të mirëqena ato. Vlerësojmë se dy "dokumenta/shkresa"²³, të paraqitura nga subjekti, nuk kanë asnjë vlerë provuese në formën e paraqitur, pasi nuk mund të verifikohet vërtetësia e tyre nëse janë mandate të rregullta. Ato nuk kanë as firmë apo vulë të shoqërisë që i ka lëshuar apo nënshkrim të personit përgjegjës. Edhe

²³ Neni 246 i KPr.Civile "Fuqia provuese e shkresave"- "Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen."



manadati i pagesës i
thjeshtë.

rezulton të jetë administruar në formën e një fotokopje të

42.2 Komisioni duhet të hetonte dhe vlerësonte besueshmërinë dhe fuqinë provuese të këtyre provave, mbështetur në nenin 49/4²⁴ të ligjit nr.84/2016 dhe nenin 81²⁵ të K.Pr.Administrative, duke kërkuar eventualisht shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me origjinën dhe subjektin lëshues të këtij dokumentacioni shkresor, si dhe duke kërkuar nga ana e shoqërisë shpk pasqyrimin në dokumentacionin fiskal të saj të këtyre pagesave.

42.3 Gjithashtu Komisioni nuk ka hetuar në lidhje me saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramit të subjektit, nëse babai i tij ka pasur mundësi financiare për mbulimin e vlerës së automjetit, pra rreth 1,748,000 lekë. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se i ati i subjektit, z. B.I ka qenë pensionist në momentin e kryerjes së pagesës së vlerës së çmimit të blerjes së automjetit. Referuar shkresës nr. [redacted], datë 29.12.2017 të [redacted]²⁶, z. P.I ka pasur një depozitë bankare sëbashku me bashkëshorten e tij, në shumën 10.350 USD, e çelur më 27.11.2003. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, konstatohet se gjatë vitit 2010 kur është blerë automjeti, më datë 20.04.2010 është tërhequr një shumë prej 3,032 USD nga H. I, shumë e cila nuk mbulon pretendimin e subjektit për pagimin e 60% të çmimit të automjetit nga i ati i subjektit të rivlerësimit. Ky fakt nuk provohet, pagesa e 60% të çmimit, edhe nëse i referohemi shkresës datë 26.12.2017 nr. Prot. [redacted] /1 të [redacted]²⁷, e cila raporton se prindërit e subjektit, kanë pasur llogari dhe depozita pranë kësaj banke (aktualisht të mbyllura²⁸), nga të cilat nuk konstatohet të jenë kryer veprime/tërheqje në vitin 2010.

42.4 Dy aktet shkresore të datës 15.06.2010 dhe 07.07.2010 ku pretendohet se janë bërë kryer pagesa në një vlerë prej 15.000 Euro në total nga ana e subjektit të rivlerësimit për blerjen e makinës, bien ndesh me deklarin e tij se zotëronte vetëm 40% të vlerës prej 21.000 Euro të automjetit. Nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar për këtë mospërputhje mes akteve të administruara dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

²⁴ Komisioni ose Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera...

²⁵ Neni 81 "Vlerësimi i provave" "Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

²⁶

²⁷

²⁸ Nga dokumentacioni i venë në dispozicion, nuk mund të verifikojmë qartë transaksionet e kryera (konstatohet depozitë të çelur në shumën 3.000.000 lekë datë 08.06.2007, kalime për çelje depozitë në shumën 1.800.000 lekë), por informacioni rezulton jo i plotë dhe nuk krijon një pamje të qartë të llogarive të prindërve të subjektit

Automjeti Land Rover Discovery, vit prodhimi 2014.

43. Gjatë hetimit administrativ, nga kontrolli i regjistrimit të sistemit TIMS dhe të dhënat e policave të sigurimit pranë AMF ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim një automjet tip "Land Rover" Discovery, vit prodhimi 2012, në pronësi të shoqërisë

shpk me targa AA885GY.

44. Përdorimin e këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën "Vetting", pavarësisht detyrimit që ka patur bazuar në dispozitat e ligjit nr.84/2016 dhe shtojcave të tij, si dhe Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, datë 10.10.2016 botuar në Fletoren Zyrtare nr.187/2016.

45. Rezulton se subjekti i rivlerësimit për automjetin e mësipër ka prerë dy polica sigurimi një vjeçare (TPL) përkatësisht për periudhat 22.09.2014-21.09.2015 dhe 15.10.2015-14.10.2016.

45.1 Në policat e sigurimit, të dhënat e të cilave janë administruar gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë mbajtës i policës në cilësinë e përdoruesit të mjetit. Ka rezultuar po ashtu, që brenda këtyre periudhave të sigurimit të plotë vjetor (TPL) për dëmet e shkaktuara të tretëve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në emër të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përdoruesit të mjetit janë prerë dhe polica sigurimi "Karton Jeshil", për të siguruar mjetin nga dëmet karshi të tretëve jashtë kufijve të shtetit shqiptar.

46. Gjatë hetimit, Komisioni i është drejtuar me pyetje subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktin e mësipër dhe mosdeklarimin nga ana e tij. Rezulton se subjekti e ka konsideruar si jo detyrues deklarimin e kësaj marrëdhënie me shoqërinë shpk, pasi sipas tij përdorimi i automjetit ka qenë për periudha të shkurtra, duke mos plotësuar kriteret ligjore për t' u konsideruar subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e përdoruesit të mjetit.

47. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në disa elementë.

47.1 Duke konstatuar mospërputhjen e përmbajtjes së dokumentacionit shkresor të përcjellë nga AMF në lidhje me periudhën e përdorimit të mjetit dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte hetuar duke marrë deklaratimet e përfaqësuesve të shoqërisë



Për burimin e krijimit, janë deklaruar të ardhurat familjare, mundësi financiare të cilat Komisioni i ka vlerësuar si të mjaftueshme.

52.Nga analiza financiare e vitit 2015 na rezulton se të ardhurat e ligjshme të subjekti dhe bashkëjetueses për këtë vit nuk justifikojnë kryerjen e këtij shpenzimi.

53.Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në disa elementë.

53.1Ekzistojnë paqartësi në hetimin e Komisionit mbi këtë fakt, ku në procesverbalin e mbledhjes së trupës gjyquese nr. 2 datë 07.05.2018, konstatohet se blerja e kësaj pasurie është justifikuar me shumën 3,000 euro, e ardhur nga shitja e një tjetër automjeti, i tipit “*BMW*”, deklaruar si e ardhur nga subjekti në deklaratën vjetore 2010. Ky automjet, sikundër u tha më lart nuk rezulton të jetë i deklaruar më parë nga subjekti dhe bashkëjetuesja në deklaratat e viteve të mëparshme.

53.2Nëse kjo e ardhur është vlerësuar nga Komisioni si burim i krijimit të automjetit “Hyundai” nuk na rezulton të jetë kryer hetim mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të pikës 3 neni D i Aneksit të Kushtetutës. Komisioni nuk ka kërkuar apo administruar asnjë dokument/kontratë që të vërtetojë shitjen dhe të ligjërojë të ardhurat.

II.C Likuiditete në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses

54. Metodologjia e përdorur në analizën financiare është si më poshtë:

i. Për analizën financiare, jemi bazuar në deklaratimet vjetore të subjektit për vitet 2003-2016, dorëzuar pranë ILDKPKI²⁹, dhe administruar në dosjen nga KPK.

ii. Të ardhura të ligjshme janë konsideruar të ardhurat neto të deklaruara nga subjekti në Deklaratat Vjetore dhe që njëkohësisht janë në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 19, pika 3 e ligjit nr.84/2016, verifikuar me dokumentacionin justifikues, sipas

iii. Shpenzim jetese është marrë në konsideratë niveli minimal i shpenzimeve të jetësës aplikuar nga ILDKPKI, ndarë proporcionalisht për çdo pjesëtar të familjes dhe përlllogaritur sipas përbërjes në certifikatën familjare të deklaruar nga subjekti ndër vite.

²⁹ Në mbështetje të ligjit nr.9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.



iv. Kursime, janë kursimet nga pagat të deklaruara nga vetë subjekti dhe bashkëjetuesja në deklaratat vjetore. Në to janë përfshirë dhe ndryshimet e gjendjes në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëjetueses, diferenca midis gjendjes në fund dhe gjendjes në fillim të çdo viti, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga bankat dhe

v. Shpenzimet e udhëtimit janë përfshirë si pjesë e llogaritjeve që nga maj 2008 deri në shtator 2009 pasi për këtë periudhë disponohen të dhëna nga sistemi TIMS. Kostoja ditore për shpenzimet e udhëtimit është llogaritur mbështetur në VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, 50 euro për person dhe ½ e kësaj vlere për fëmijet e mitur. Për udhëtimet me charter (*paketë*), është llogaritur kosto 100 euro dita dhe ½ e kësaj vlere për fëmijet e mitur. Çmimet e biletave janë marrë referuar çmimeve mesatare të biletave nga verifikimet online. Nuk janë përfshirë në llogaritje shpenzimet e udhëtimit të deklaruara nga Gjykata e Lartë si vizita pune, të cilat i përkasin periudhës 2013-2015³⁰.

vi. Në analizën financiare janë përfshirë dhe shpenzimet e mobilimit në vlerën 2.600.000 lekë të deklaruara nga subjekti për herë të parë në pyetësoin e KPK me nr.2190 prot., datë 22.12.2017. Meqënëse subjekti nuk ka deklaruar periudhën e kryerjes së këtyre shpenzimeve, i kemi marrë në konsideratë të ndarë proporcionalisht për vitet 2003-2016.

Likuiditete në pronësi të subjektit të rivlerësimit z Edmond Islamaj

55. Depozitë në shumën 6,857.12 euro, në emër të subjektit të rivlerësimit pranë “Intesa San Paolo Bank” krijuar në vitin 2000, në shumën 5.191 euro dhe shtuar për interesat bankarë. Sipas deklaratës periodike 2003 subjekti ka deklaruar si burim krijimi “kursime në vite”. Nga analiza financiare e subjektit deri në vitin 2000, rezulton që subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj shume. Hetimi dhe vlerësimi i Komisionit gjendet i drejtë.

56. Llogari rrjedhëse në shumën 1.191.617, 08 lekë në ³¹ dhe Kartë krediti në shumën limit 200.00 lekë;

57. Depozitë cash në shumën 20.000 euro në emër të subjektit, pranë , çelur në datë 19.04.2016, burim krijimi: nga të ardhurat ndër vite;

³⁰ Sipas shkresës së Gjykatës së Lartë, shkresë nr . datë 26.12.2017.

³¹ Vërtetuar me shkresë nr . datë 05.07.2017.



Likuiditete në pronësi të bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit znj S.T

58. Depozitë në shumën 12.101,40 USD (balanca në datë 16.01.2017), në emër të bashkëjetueses, në formën e kursimeve pranë _____, çelur në datë _____ në vlerën 10,000 USD. Për burimin e krijimit janë deklaruar të ardhurat familjare dhe interesat bankare. Na rezulton se në deklaratën vjetore të vitit 2005 subjekti *nuk ka deklaruar të ardhura dhe kursime të bashkëjetueses*, ndërkohë referuar deklaratës vjetore të vitit 2006, bashkëjetuesja ka deklaruar çeljen e një depozite kursimi në _____, në shumën 10,000 USD, burimi i krijimit: nga kursimet e vitit 2005 (5.000 USD) bashkë me kursimet e vitit 2006 (5.000 USD). Nga analiza financiare e të ardhurave familjare për periudhën 2005-2006, shuma e depozituar prej 10,000 USD në datë 18.12.2006 mbulohet nga të ardhura të ligjshme familjare.

59. Depozitë cash në shumën 15.000 euro të bashkëjetueses, pranë _____, çelur në datë 19.04.2016, burimi: *nga të ardhurat familjare*;

59.1 Për likuiditetet e deklaruara si më sipër, në llogarinë rrjedhëse të pagës dhe depozitat e kursimit në _____ dhe _____ rezulton se _____³² dhe _____³³, konfirmojnë deklarin e subjekti dhe në datën 19.04.2016, subjekti dhe bashkëjetuesja kanë depozituar pranë bankave _____ dhe _____, shumat respektivisht 20,000 euro në _____ në emër të E.Islamaj dhe 15,000 euro në _____ në emër të S.T. Këto depozita janë deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2016, me burim krijimi: *krijuar nga kursimet e vëna nga të ardhurat nga paga ndër vite*.

59.2 Në deklaratat vjetore 2003-2016, subjekti dhe bashkëjetuesja deklarojnë vit pas viti kursime në seksionin: "*ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*" respektivisht:

Viti	Kursime subjekti	Bashkëjetuesja	Bashkëjetuesja
2003	-	-	
2004	-	-	
2005	600,000	-	
2006	700,000	-	
2007	400,000	100,000	
2008	600,000	500,000	
2009	750,000	650,000	
2010	700,000	550,000	3000 eur
2011	800,000	650,000	

³² Me shkresë nr 57644/1 datë 04.01.2018.

³³ Me shkresë 63324/1 datë 11.01.2018.

2012	860,000	250,000	-
2013	500,000	200,000	
2014	150,000	-	
2015	150,000	-	
Totali	6,200,000	2,900,000	3,000 euro

59.3 Në total, shuma e deklaruar si kursime Cash dhe depozita bankare ndër vite nga subjekti dhe bashkëjetuesja rezulton 9,110,000 lekë dhe 3,000 euro.

59.4 Në deklaratat vjetore 2003-2016 subjekti dhe bashkëjetuesja nuk rezulton të kenë deklaruar për asnjë vit ndryshimet në llogaritë bankare të pagave.

59.5 Shuma e depozituar në datë 19.04.2016 prej 35,000 euro në total (4,844,350 leke³⁴) rezulton më e vogël se shuma e deklaruar si e kursyer ndër vite nga vetë subjekti (diferencë prej 4,264,650 lekësh).

59.6 Nuk rezulton të jetë kryer hetim nga Komisioni mbi diferencën në total të kursimeve Cash të deklaruara ndër vite me shumën e depozituar në 19.04.2016, diferencë e cila rezulton mbi limitin 1.5 milionë lekë, referuar pikës 17 të Udhëzimit nr.4095 datë 10.10.2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 10.10.2016.

59.7 Mbështetur në deklaratimet vjetore të subjektit mbi kursimet e krijuara, nga analiza financiare vit pas viti për periudhën 2003-2016, mbi mundësinë e subjektit për mbulimin e kursimeve të deklaruara me të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3 neni D i Aneksit të Kushtetutës³⁵, rezulton se subjekti dhe bashkëjetuesja kanë pasur mundësi të mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitet 2003, 2004, 2006, 2007, 2013, 2014, 2016.

59.8 Për vitet: **2005, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2015** na rezulton se subjekti dhe bashkëjetuesja nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme, kursimet e deklaruara në deklaratat vjetore të interesave privatë, konkretisht³⁶:

Përmbledhëse	2005	2008	2009	2010	2011	2012	2015
Të ardhura të ligjshme të	1,141,183	2,060,383	2,581,607	2,381,498	2,653,628	2,355,809	1,576,316

³⁴ Sipas kursit të BSH dt 19.04.2016.

³⁵ Referoju metodologjisë.

³⁶ Referoju metodologjise financiare shpjeguar ne 18.12

deklaruar (familjare) ³⁷							
Shpenzime familjare ³⁸	667,857	1,441,381	1,194,165	1,688,945	1,550,187	1,784,763	2,319,152
Likuiditete ³⁹	600,460	1,229,812	1,553,131	1,700,723	1,584,702	1,804,009	98,127
Diferenca e pambuluar e kursimeve	-127,134	-610,810	-165,689	-1,008,170	-481,261	-1,232,963	-840,963

Në total kjo vlerë e diferencës së pambuluar të kursimeve Cash shkon në vlerën -4.466.990 lekë.

59.9 Nga parashtrimet e subjektit datë 28.05.2018, rezulton se i vetmi vit për të cilin nga Komisioni është konstatuar pamundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara me të ardhura të ligjshme, është viti 2015, vit për të cilin subjekti në parashtrimet e tij të datës 28.05.2018, deklaroi se: “...një pjesë e shpenzimeve të udhëtimit është mbuluar nga punëdhënësi si dhe fondacioni në rolin e anëtarit themelues të shoqatës...”. Gjithashtu, subjekti si burim për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2015 deklaroi të ardhurat nga shitja e autoveturës të ardhura të cilat nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës pasi subjekti nuk ka mundur të vërtetojë arkëtimin e tyre (trajtuar në pikën 14.).

59.10 Nuk rezultoi të jetë konstatuar dhe hetuar nga Komisioni pamundësia financiare e subjektit për të mbuluar kursimet e deklaruara për vitet si mësipër me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 i Aneksit të Kushtetutës, apo dhe saktësia e deklaramit për vitet të cilat rezultojnë me diferencë negative në mbulimin e kursimeve me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit 32/5 të Ligjit nr 84/2016.

59.11 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në lidhje me të dhënat e sistemit TIMS për udhëtimet jashtë shtetit të subjektit të rivlerësimit, bashkëjetueses znj. S. T dhe dy fëmijëve të mitur.

59.12 Bazuar në të dhënat e përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. prot., datë subjekti i rivlerësimit për periudhën maj 2008 – shtator 2016 ka kryer 64 udhëtime jashtë territorit shqiptar, bashkëjetuesja znj. S. Toska 56

³⁷ Totali të ardhurave të ligjshme neto nga pagat dhe qeraja, në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

³⁸ Shpenzime jetese, udhëtimi dhe mobilimi, sipas metodologjisë shpjeguar mësipër si dhe shpenzime për shtimin e pasurisë, deklaruar nga vetë subjekti.

³⁹ Sipas deklaramit të subjektit në DV dhe ndryshimit të gjëndjes në llogaritë rrjedhëse bankare të subjektit dhe bashkëjetueses.



udhëtime jashtë territorit të shtetit shqiptar, kurse fëmijët e mitur përkatësisht 29 dhe 30 udhëtime jashtë territorit të shtetit shqiptar.

59.13 Me shkresën nr. _____ prot., datë _____ Gjykata e Lartë ka informuar Komisionin se për periudhën 2011-2016, gjatë të cilës subjekti i rivlerësimit kryen detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë, shpenzimet e udhëtimit si pjesë e delegacioneve zyrtare të kësaj gjykate janë mbuluar nga kjo e fundit në 8 raste.

60. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për likuiditetet e deklaruara gjatë viteve nga ana e subjekti të rivlerësimit dhe personit të lidhur qëndrojnë në disa elementë:

60.1 Në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr.84/2016 deklaratat e plotësuara gjatë viteve mund të përdoren si provë. Në të tilla rrethana ligjore, ndërkohë që konstatohet për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesen e tij një vlerë e deklaruar si e kursyer përgjatë viteve prej 4.466.990 lekë, e cila nuk mbulohet nga diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera, Komisioni do të duhej të hetonte për të sqaruar arsyet e kësaj difference në lidhje me kursimet e deklaruara ndër vite, me vlerën e deklaruar në deklaratën "Vetting" dhe vendndodhjen eventuale të kësaj vlere monetare.

60.2 Lidhur me udhëtimet jashtë territorit të shtetit shqiptar të subjektit të rivlerësimit, bashkëjetueses dhe fëmijëve të mitur, nisur nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit se gjatë pjesës më të madhe të këtyre udhëtimeve ka qëndruar pranë të afërmeve të tij, Komisioni duke përdorur të njëjtin standart të përdorur gjatë hetimit administrativ që ka konkluduar me marrjen e vendimit nr.13, datë 05.04.2018, do të duhet të kishte hetuar në lidhje me adresat e sakta të familjarëve të subjektit në këto vende, ku pretendohet se ai ka qëndruar gjatë udhëtimeve jashtë vendit me qëllim përlllogaritjen e shpenzimeve të kryera.

III. Çështje të tjera.

Informacion nga Prokuroria e Përgjithshme mbi pronarët e mjeteve të përdorura nga subjekti i rivlerësimit.

61. Rezulton se me shkresën nr. _____ prot., datë _____ Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një kërkesë për informacion në lidhje me rekordet kriminale të 12 shtetasve, pronarë të mjeteve motorike të përdorura ndër vite nga subjekti i rivlerësimit. Në mungesë të një përgjigje të administruar nga Prokuroria e Përgjithshme për këtë kërkesë,



nuk rezulton që Komisioni të ketë hetuar më tej në lidhje me këtë fakt të evidentuar si të nevojshëm për verifikim nga vetë Komisioni.

Likuiditetet e personave të tjerë të lidhur.

62. Nisur nga konstatimi i Komisionerit Publik për një hetim jo të plotë në kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit z. Edmond Islamaj, marrë në konsideratë se disa veprime juridike dhe financiare që lidhen me te drejtat e pronësisë së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij janë kryer me kundërpalë prindërit e tyre, në konsideratë të hetimit eventual nga ana e Kolegjit mund të vlerësohen dhe faktet e mëposhtme.

63. Banka _____ konfirmon depozitë në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit H. dhe B. I (çelur në 27.11.2003 për 10,350 \$ dhe gjëndje në 31.12.2015 me 6,007\$); depozitë në emër të babait të bashkëjetueses z. A. T (datë fillimi 09/05/2006 dhe datë mbarimi 03/05/2008, me gjëndje 60,000\$).

64. Banka _____ konfirmon llogari në emër të atit të subjektit të rivlerësimit z B. I, çelur në datë _____, me transaksion depozitë datë _____ në vlerë 3,000,000 lekë); llogari dyemërore në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit H dhe B. I, (depozitë në vlerën 1,500,000 lekë, datë 14/09/2009);

65. _____, konfirmon llogari personale dhe depozita kursimi në emër të prindërve të bashkëjetueses A. T dhe H. T nga ku ⁴⁰ rezulton se aktualisht znj. H.T, ka 1 depozitë aktive me afat maturimi 5 vjeçar me gjendje 1.000.000 lekë, ndërsa z.A.T në datë 18.8.2011 ka depozituar pranë kësaj banke shumën 30.000 USD, aktualisht depozitë e mbyllur).

66. Banka _____, raporton llogari dhe depozita në emër të prindërve subjektit të rivlerësimit dhe atyre të bashkëjetueses z A. T, H. T dhe B. I (nga lëvizjet e llogarive bankare të A.T, sipas ekstratit të bankës _____, vërejmë që nga viti 2006 e në vazhdim, janë kryer nga ai vetë transaksione në shuma të konsiderueshme, duke nisur me derdhje *cash* në datë 31.10.2006, shumën 60.000 euro me përshkrimin "*të ardhura nga shitja e pronës*", datë 31.05.2007, derdhje 20.000 euro me përshkrimin "*të ardhura nga shitja e dyqanit*", dhe disa transaksione të tjera kryesisht këmbime valutore dhe transferta dërguar jashtë shtetit me përshkrimin "*dhuratë familjare*", në shumat 4.000-8.000 USD. I vetmi dokument i administruar që mund të vlerësojmë për ligjshmerine e këtij likuiditeti është një kontratë noteriale shitblerje e datës

⁴⁰ Shkresë nga _____ nr _____ /prot datë _____ protokolluar në KPK me shkresë në 1181/31 datë 05.01.2018



20.06.2007, ku z. A.T ka shitur njësi shërbimi në vlerë 4.200.000 lekë, e cila nuk korrespondon në datë e në vlerë me transaksionet e mësipërme.

Të dhënat nga OSSHE.

67.Në përgjigje të shkresës së Komisionit nr. prot., datë 01.02.2018 OSHEE⁴¹, ka sqaruar se “me gjeneralitetet Edmond Islamaj identifikohen 3 abonentë në instancën Durrës, me gjeneralitetet B.I identifikohet 1 abonent në instancën Vlorë (kontratë njësi shërbimi), me gjeneralitetet H.I identifikohen 2 abonentë në instancën Vlorë (kontratë familjare + njësi shërbimi), me gjeneralitetet S.T (bashkëjetuesja) identifikohen 2 abonentë në instancën Durrës, me gjeneralitetet A.T (i ati i bashkëjetueses) identifikohen 2 abonentë në instancën Durrës, me gjeneralitetet Rr.T (i ati i bashkëjetueses, paraqitet me 2 emra) identifikohet 1 abonent në instancën Durrës.

68.Për kontratat në instancën Vlorë, për B. I dhe H.I, konstatojmë se OSShE sjell në vëmendje mungesën e të dhënave të sakta mbi identifikimin e abonentëve (nr.identifikimi dhe atësi) duke qenë se legjislacioni në fuqi i kohës nuk detyronte marrjen e këtyre të dhënave. Për këtë arsye, në bazën e të dhënave të operatorit të shpërndarjes së energjisë, konsumatorëve i mungojnë të dhënat e sakta dhe figurojnë të regjistruar vetëm me emër dhe mbiemër. Komisioni në këtë pikë e ka ndërprerë hetimin duke mos verifikuar nëse konsumatorët që referon përgjigja e OSHEE janë subjekti dhe personat e lidhur me të, sikundër vetë Komisioni fillimisht kishte pyetur OSHEE.

69.Nga dokumentacioni rezulton që kontratat për abonentët (tip familjar dhe tip shërbimi furnizimi–njësi) datojnë nga viti 2001 deri në 2018. Referuar vendimit të ERE nr.22 datë 24.02.2012 “Për miratimin e rregullores së lidhjeve të reja, marrëveshjes së lidhjes dhe formularit të aplikimit për lidhje të re, rubrika “dokumentat që kërkohen për aplikim janë:
- Kërkesë për furnizim me energji elektrike, fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportë, vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronës, të tilla si kontratë shitblerje, akt qeraje, akt dhurimi ose akt ndarje pronësie, dokumenta legalizimi, etj⁴².

⁴¹ Sipas shkresë përgjigje OSHEE nr. prot datë

⁴² Në rastet kur kërkuesi është individ dhe nuk paraqitet personalisht duhet të paraqesë autorizim me shkrim nga mbajtësi i kontratës, shoqëruar me kopje Karte ID të mbajtësit.



IV. Kërkimi i ankimit

70. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit, C/2, D, Ç dhe F/3 të Aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve, nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenin 59/1 të ligjit nr.84/2016.

71. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt;

72. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa patur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

73. Referuar pikës 3, të nenit F të Aneksit të Kushtetutës ku sanksionohet se: “3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.”;




74.Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe vetëm pasi të ketë kryer vetë Kolegji një hetimi të plotë për kontrollin e deklarimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit z. Edmond Islamaj, mbështetur në provat e mbledhura në përfundim të këtij hetimit të plotë, në zbatim të nenit 59 dhe 66 të ligjit nr.84/2016 të vendosë në mënyrë alternative:

-Ndryshimin e vendimit nr.22, datë 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

ose

-Lënien në fuqi të vendimit nr.22, datë 07.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK



Florian BALLHYSA

